

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“ILIRIA BUSINESS PARK” " SHPK

Sot, më datë 05.08.2022, u paraqiten personalisht:

- **Z. Marjan Kola**, i datëlindjes 03/05/1986, shtetas shqiptar, lindur ne Rreshen dhe banues ne Lezhe, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr I60503037G dhe Nr. Pashaportes 032925554

I cili përpiloi këte akt themelimi të shoqërisë tregtare “**Iliria Business Park**” shpk, me termat e mëposhtme:

NENI 1

Forma Ligjore

Të themeloj Shoqërinë Tregtare “**Iliria Business Park**” shpk, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri “**Iliria Business Park**” shpk, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

NENI 2

Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

NENI 3

Emri dhe vula e shoqërisë

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit “**Iliria Business Park**” shpk dhe me emrin tregtar “**Iliria Business Park**” shpk. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

NENI 4

Objekti i veprimtarisë

Veprimtaria e shoqërisë do të jetë:

Transport kombetar dhe nderkombetar udhetaresh me autobus. Transport kombetar dhe nderkombetar te mallrave te ndryshme me kamion per te trete dhe me qera.



Sherbime Servisi per Autobuza, Sprintera per vete dhe per te tretet, Parking, Lavazh, Shitblerje makinash dhe dhenie me qera.

Bar, Restorat etj dhe cdo veprimtari tjeter qe lejohet me ligj.

NENI 5

Selia e Shoqërisë dhe Afati

Selia e shoqerise ndodhet ne Adresen : Laç,Rruga Qafa Pazarit, mbikalimi i Sanxhakut ne Autostrade ,numr i Pasuri nr.46/85 ,vol 18 faq 2, Nr Pasurie 46/32/1, vol 18,faq 3.

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

NENI 6

Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar është Lekë 1.000.000 (njemilion) lek dhe zotërohet nga ortaku themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar eshte: 1.000.000 (njemilion leke)

Vlera e paguar: 1.000.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

Kapitali themeltar eshte mbuluar tërësisht nga ortaket themelues.

NENI 7

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare “**Iliria Business Park**” zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	Marjan Kola
Numri i kuotave :	1
Numri i pjeseve :	1
Pjesemarrja ne Shoqeri :	100,00 %
Lloji i kontributit:	Ne para
Vlera e kontributit	1.000.000 (njemilion) leke

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas regjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

NENI 8

Organet Drejtuese

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:



1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

NENI 9

Administratori/ët

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve i cili zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqërisë do të jete :

- **Z. Marjan Kola**, i datëlindjes 03/05/1986, shtetas shqiptar, lindur ne Rreshen dhe banues ne Lezhe, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i kartes se identitetit me nr 160503037G dhe Nr. Pashaportes 032925554

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 10

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesëmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

NENI 11

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdurojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

NENI 12

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

NENI 13

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaket Themelues, u gjet sipas vullnetit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njohes i gjuhes shqipe.

ORTAKET THEMELUES I VETEM

Marjan Kola

